



Npi – 01/157 datë: 03.06.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 03.06.2021 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I M B L E D H J E S Ë - V - T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S Ë S H T I M E S**  
E mbajtur më: 03.06.2021, (e enjte) në ora 10.<sup>00</sup> h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, znj.Arbenita Halimi, z.Naim Zejna, z.Skender Hysëni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi. Në mbledhje përveq anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Drejtorat, nga ZKF-ja znj.Kimete Uka, z.Bujar Ferati, Nga OJQ "YAHR" – z.Egzon Ahmeti, dhe Praktikantja znj.Yllka Dashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit.

Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 20.04.2021,
2. Pyetje-Pergjigje,
3. Propozim-Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale në Ngastrën Kadastrale Nr.333-4, S= 21986 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale-Davidovc, (Rekomandimi i Komisionit Vlerësues)
4. Raporti tremujor Buxhetor Janar-Mars 2021,
5. Draft-Koorniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024,
6. Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha, sipas rekomandimit të MPL-së,
7. Draft-Statuti i ri i QKMF-së "Vezir Bajrami" në Shtime, (Pas diskutimit publik)
8. Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht, (Pas diskutimit publik)
9. Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së "Adem Jasharit". (pas diskutimit publik)

10. Informatë nga Sektori i Bujqësisë për mbjelljet pranverore,

11. Informatë nga DKA-ja për profilet e shkollës së mesme,

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z. Ruzhdi Jashari;** Përshëndetje, ne si VV-ë e përkrahim biznesin por kërkojmë që pika e 3, të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin që të kemi siguri se a jemi në përputhje me Ligjin, të cilën duhet ta konstatoi Zyra Ligjore. Pastaj edhe kemi fillimin e fushatës zgjedhore sepse Naim Ismajli e ka shpallur kandidaturën për kryetarë të Komunës.

**z. Besnik Seferi;** Përshëndetje, ndoshta zyrtari ligjor mundet me na dhënë sqarime për pikën e 3 të rendit të ditës.

**z. Perparim Ramusa;** Përshëndetje, unë pajtohem me rendin e ditës që është propozuar. Sa i përket kandidimit të Kryetarit, kjo është qështje e subjektit politik të PDK-së se ken e kandidon. Edhe unë jam që të na jep sqarime zyrtari ligjor.

**z. Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor;** Përshëndetje, mua më duhet pak kohë për ta konfirmuar këtë çështje. Neni 10 i Ligjit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim thotë që: Kuvendi nuk mund të marrë vendim për dhënien e tokës komunanle në shfrytëzim 6 muaj pas ditës kur Presidenti i shpallë zgjedhjet.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin prej 18 delegatëve prezentë në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 14 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 4 vota "Abstenim", Aprovoi rendin e ditës pa ndryshime.**

#### Pika 1

##### Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 20.04.2021

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z. Rexhep Gashi;** Disa diskutime të mia nuk janë përfshirë në ekstrakt procesverbal. Kam thënë se një pikë nuk përputhet me Planin e Punës së Kuvendit. Konsideroj se është një neglizhencë teknike.

**z. Besnik Seferi;** Uroj, Idajet Rexhepi që ju ka bashkëngjitë në punën e tij edhe një punëto re, dhe kërkoj që kjo punëto re të bëhet e rregullt për punët në sektorin e Kuvendit, sepse është vërtetuar se aty vetëm Idajeti nuk po mundet me i kryer të gjitha punët.

**z. Naim Zejna;** Edhe ne kemi kërkuar disa herë, që në sektorin e Kuvendit të punësohet edhe një zyrtarë, sepse po ka shumë punë, kjo po shihet edhe me procesverbalet që kemi mbetur shumë mbrapa, me këtë rast e kam një pyetje për zyrtarin e Kuvendit që të na tregojë sakt se sa jemi mbrapa me procesverbale?

**z. Idajet Rexhepi, zyrtar i kuvendit;** Përshëndetje, unë po sqaroj se sa i përket procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit, jemi dy procesverbale mbrapa (të pa kryera) ndërkaq që mbrapa jemi edhe të Komitetet, si psh. Komitetit për Politikë dhe Financa - 3, Komiteti për Komunitete - 2, Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - 2, Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Ambient dhe Shërbime Publike - 2. Arsyet janë dy kryesore, e para mungesa e stafi në sektorin e Kuvendit dhe e dyta mungesa ime në punë për një muaj për shkak të sëmundjes me Kovid19.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin prej 18 delegatëve prezentë në mbledhje.

**Kuvendi i Komunës, unanimitisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 20.04.2021.**

#### Pika 2

##### Pyetje – Përgjigje

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z. Skender Hyseni;** Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Unë edhe më herët e kam ngritur çështjen e kanalizimit fekal në fshatin Muzeqin, edhe në Komitet por edhe në Kuvend, kanë dështuar përpjekjet

për me hap kanalizimin. Ju lutem që të ndërmerrni diçka sepse ujrat e zeza kanë dalë mbi sipërfaqe, ose të bëni një zgjidhje alternative sepse gypat janë shtypur, dhe nuk po funksionojnë?

**Z. Muhamet Adema:** Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Pyetje për DSHP-në, kur do të fillojë riparimi i gropave që janë krijuar në rrugët e komunës së Shtimes? Pyetje për DSHMS-në, pse Qendra e Mjekësisë Familjare në Petrovë nuk ofron shërbime shëndetësore? Pyetje për DKA-në se kurë do të fillojë të funksionojë Çerdhja e re në Shtime?

**Z. Shafiq Dauti:** Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Kemi bërë disa kërkesa, të cilat unë po kërkoj që të realizohen, sepse janë kërkesa shumë të nevojshme? Në fshatin Carralevë (që i kanë thënë te varri i partizanit) është krijuar një deponi e mbeturinave kur do të pastrohet sepse aty është një bukuri natyrore?

**Z. Reshat Mujota:** Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Kam një pyetje për DSHP-në, Parqet e ndërtuara disi nëpër fshatra, çka po ndodh me to dhe a do të mirëmbahen? Pyetje për DPUKGIJ-në, a është bërë matja e parcelës 333/4 në Davidovc për biznese, dhe a janë të specifikuara lokacionet se për cilin vend cili pronarë ka konkuruar? Kam një kërkesë për DKA-në, a mundet ma na i sjellë kontratat për numrin e të punësuarve në arsim gjatë periudhës së dytë të vitit 2020, dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, si në arsim pastaj te stafi teknik, po ashtu edhe në Çerdhe?

**Z. Besnik Seferi:** Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Sa i përket rregullimit të shtratit të lumit në Carralevë, kemi vërejtë se për shkakë të punës jo cilësore të vendosjes, gypat e kanalizimit, kanë dalë mbi sipërfaqe, unë mendoj se duhet të rregullohen, kështu që kërkoj nga Inspektorati që ta vizitoj këtë lokacion dhe të ndërmarrë masat e nevojshme? Banorët në fshatrat Carralevë dhe Reçak janë të rrezikuar nga Qenët Endacak, kërkoj që të ndërmerrët diçka për ta?

Pyetje për DSHP-në, në Komunën tonë, mungojnë shumë shenja të komunikacionit, çka jeni duke ndërmarrë për vendosjen e tyre? Në rrugën "Anton Çeta", kalojnë kamiona me pasha të rënda, pyetja është a marrin leje ata në Komunë, sepse për veç që e dëmtojnë rrugën edhe i rrezikojnë fëmijët?

Trotuarët po rregullohen, mirëpo shtyllat elektrike po qëndrojnë në mes të trotuarit, a është dashur të bëhet planifikimi më i mir, edhe për faktin që po bëhet stërngarkimi i tyre me kablo të operatorëve të ndryshëm të internetit? Pyetje për DSHP-në, KRM "Pastërtia", nuk po i merr rregullisht mbeturinat, si qëndron puna? Pyetje për DSHP-në, kur do të bëhet pastrimi i trotuarve?

**Z. Fehmi Hysenaj:** Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Shqetësimi im është mungesa e përgjigjeve në pyetjet tona si dhe mangësitë në përgjigjet e dhëna, prandaj kërkoj nga Kryetari që këtë qështje ta adresoi te drejtorët për të gjitha pyetjet që i parashtrujmë?

Pbashtu shqetësimi im është edhe për sa i përket përgjigjes drejtorin që përgjigjet se unë nuk jam e detyruar që t'iu jap juve përgjigje, por vetëm Kryetari?

**Z. Ruzhdi Jashari:** Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Pyetjet që nuk kam marr përgjigje janë dy, ndërsa të tjerat janë gjysëmake, nuk e kemi informatën për vendimet e pa zbatuara, prandaj kërkoj që kjo pyetje të përsëritet? Pyetja për inspektoratin po ashtu është pa përgjigje? Edhe pyetja tjetër është pse Komuna ka marrë me qira Vetura e pajisje, kompjuterë, llaptopë etj. Ndërkaq që ka pasur paisje të tilla?

**Z. Naim Zejna:** Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Kam bërë pyetje për sa i përket druve të shkolla profesionale, e që nuk kam marrë përgjigje prandaj po e përsëris pyetjen prap? Nuk kam marr përgjigje edhe sa i përket pyetjes për pagesën e pagave jubilarë edhe këtë pyetje po e përsëris? Puseta të rruga "Ahmet Shtimja", nuk është rregullar ende, pyetja është kur do të rregullohet?

Pse ka vonesa të mëdha për marrjen e mbeturinave të rruga "Ahmet Shtimja" dhe "Komandant Kumanova", edhe duhet me pas kujdes sepse po ka rrjedhje të kamionat e mbeturinave? Kush e ka shpallë Shesh "Ahmet Shtimja" kur dihet se këte e bënë Kuvendi?

Më sa e di unë kontrata është që mbeturinat me i marrë para shtëpisë e jo punëtorët me thanë se neve na ka thënë drejtori se mbeturinat duhet me i marrë më larg (psh. të rruga kryesore)? Cila është dinamika e realizimit të projekteve kapitale në përgjithësi?

faqe 3 nga 9

faqe 3 nga 9

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Përsëritet, Pytje ka pasur por shumë ishin komente. Kuvendi ka diskutuar që drejtorat të marrin pjesë në mbledhje dhe të japin përgjigje deri në detaje, drejtpërdrejt që mbledhje. Unë po dua me pas saktësi kështu që edhe unë do të jemë prezent në mbledhje bashkë me drejtorat. Unë po kërkoj që këtë propozim ta votoni. Sa i përket investimeve kapitale jemi mbrenda dinamikës kohore, mirëpo mund të ketë vonesa në kuptimin e shpalljeve, dhe procedurës së prokurimit.

Buxheti e kemi pak me vonesë mirëpo jemi mbrenda afateve kohore. Nuk kemi asnjë projekt që është shtyrë për shkak të ankesave. Qenët endacak janë dhe do të jenë një kohë të gjatë problem për Komunën tone por jo vetëm për Komunën tonë. Dje ka përfunduar cikli i trajtimit të qenëve ku i kemi shifrat e sakta dhe mund t'ju japim. Ne nuk mund të ndërtojmë strehimore për shkak të buxhetit. Rreth 60 qenë ne i kemi dërguar në strehimore. Sa i përket shtyllave, unë jam takuar me drejtorin gjeneral, i cili ka dhënë premtime por asnjëherë nuk janë realizuar, ata janë të ngadalshëm në punën e tyre. Ata i'u japin leje operatorëve të internetit për vendosje të kabllove, kështu që edhe unë i ndaj shqetësimet me ju për sa i përket kësaj çështje, kemi edhe fletëparaqitje në Gjykatë për këtë kundër KEDS-it.

Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve e parqeve, shumë shpejt do të kemi një kontrat kornizë për mirëmbajtjen e tyre. Kemi problem me kompanin KRU "Prishtina" që merret me furnizimin e qytetarëve me ujë dhe mirëmbajtje të kanalizimit, sepse nuk po shkon në ritmin e dëshiruar. Problemi i funksionimit të kompanive publike është evident. Ata kanë numër të madhë të puntorëve. Në të ardhmen ne duhet të gjejmë alternativa të tjra, p.sh kontraktimi i kompanive private.

**z.Naim Zejna;** Nuk pati përgjigje sa i përket pyetjes për pagat jubilarë, sepse në Komunën e Kaçanikut i kanë pagur; dhe pse në Shtime jo, por po pritët që kjo çështje të shkon përmes Gjykatës?

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Te pagat jubilarë arsyeja lidhet me faktin se ne nuk jemi palë kontraktuale, e para dhe e dyta është se Kuvendi nuk ka marrë asnjë vendim financiar për pagesën e tyre, prandaj ç' do kushë që e bënë pa procedurën gjyqësore dhe pa vendim është kundërligjore.

Dua të sqaroj një here e mirë se Komuna e Shtimes nuk ka marrë asnjë veturë e asnjë pajisje me qira. Në qeverisjen e Kryeministrit Haradinaj është marrë vendim për mosblerjen e veturave, por që të merrën me qira, kështu që edhe tarifën edhe operatorin e kanë caktuar Qeveria. Ne i kemi në dispozicion dy vetura nga Qeveria. Po ashtu edhe sa i përket furnizimit me pajisje teknike në Komunën tonë është bërë përmes Qeverisë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Unë po mendoj se ata drejtorat që janë të gatshëm të japin përgjigje të drejtpërdrejt, le ta bëjnë ndërsa nëse kërkojnë të dhëna me shifra le ta shënojnë dhe pastaj japin përgjigje me shkrim.

**Kryesuesja zj.Medina Brahaj;** Sçaroi se ne, në Kuvend nuk kemi pasur vullnet që ta ndryshojmë praktikën tonë të punës që drejtorat me dhënë përgjigje të drejtpërdrejt.

**z.Naim Zejna;** Unë kam qenë ai që nuk jam pajtuar me ndryshimin e praktikës që drejtorët me na dhënë përgjigje të drejtpërdrejt, pikërisht për faktin se përgjigjet e disa drejtorëve kërkojnë një analizë më të mirë, kështu që pa një vendim të Kuvendit nuk mundemi me e ndryshuar.

**z.Shefki Dauti;** Edhe vetë kërkesa e drejtorëve ka qenë me u përgjigj drejtpërdrejt. Mipo unë mendoj se nëse ka nevojë, drejtori mund të japë përgjigje edhe me shkrim.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimisht Aprovoi vendimin për pjesëmarrjen e rregullt të gjithë drejtorëve komunal, në mbledhjet e Kuvendit. Drejtorët obligohen që të japin përgjigje në mbledhje; drejtpërdrejt në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit, përveq në rastet kurë, kërkohet një përgjigje me shkrim ose ndonjë analizë e posaqme.**

### Pika 3

**Propozim-Vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë pronën Komonale në Ngastrën Kadastrale Nr.333-4, S= 21986 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale-Davidovc. (Rekomandimi i Komisionit Vlerësues)**

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Para se të fillojmë shqyrtimin e kësaj pike, unë po deklaroj publikisht se kam konflikt interesi nëse rri në shqyrtimin e kësaj pike, prandaj unë po e ftoj anëtarin më të vjetër të Kuvendit z.Ruzhdi Jasharin që ta kryesojë mbledhjen për këtë pikë, dhe e ftoj që ta zë vendin dhe ta kryesojë mbledhjen e Kuvendit. Mbledhjen e lëshoi në ora 12.47h.

**z.Milot Deliu;** Edhe paraqes konflikt interesi dhe e lëshoi mbledhjen në ora 12.47h. për këtë pikë.

**Kryesuesi i mbledhjes, z.Ruzhdi Jashari;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit mori në detyrë kryesimin e mbledhjes së Kuvendit për pikën e tretë të rendit të ditës, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Reshat Mujota;** Unë nuk mund të votoj pjesërisht, por kisha dashur të votojmë në pako. Dhe për këtë arsye unë në fillim bëra pyetjen se a është bërë ndarja e pjesëve të kësaj parcele, për ata që do ti marrin këto pjesë në shfrytëzim.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Po është e sigurtë se ndarja do të bëhet ashtu që të gjithë të kenë qasje në rrugën kryesore. Komisioni ka bërë një rekomandim për Kuvendin, ku vetëm njërin aplikant e ka përjashtuar për shkak të kriterëve teknike.

**Kryesuesi i mbledhjes, z.Ruzhdi Jashari;** Këtë pikë e kemi trajtuar edhe në KPF dhe është marrë Rekomandim që drejtoria me ardhë me skicë për secilin operatorë, si dhe kemi kërkuar përmbushjen e aspektit Ligjor. Për me i hjekë dilemat unë po kërkoj që Zyrtari Ligjor me na e lexuar nenin 6 të rregullores së Qeverisë. Unë nuk dua që ti futi bizneset në lojëra nëse nuk është procedura në përputhje me Ligjin.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Kemi një vendim nga Kuvendi, për fshatin Dugë ku MAPL-ja ka konfirmuar lidhshmerinë e vendimit.

Komuna e ka listen e gjerë dhe të ngusht të pronave e cila ka shkuar në MAPL dhe ka qenë në rregull.

Dilema ka pasur për gjashtë mujorin para zgjedhjeve e që zyrtari ligjor e sqaroi, kështu që me bazen ligjore jemi okej.

**z. Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor;** Qka po kërkon konrektisht nga zyrtari ligjor?

**Kryesuesi i mbledhjes, z.Ruzhdi Jashari;** Po e përsëris edhe njëherë pyetjen, për me i hjekë dilemat unë po kërkoj që Zyrtari Ligjor me na e lexuar nenin 6 të rregullores së Qeverisë.

**z. Lulzim Muharremi, zyrtar ligjor;** Lexoi nenin gjashtë të rregullorë te Qeverisë

**z.Isak Muslija;** Shumica e procedurave janë të gabushme. Zyrtari ligjor është dashur të konsultohet para se të përpilohen pikat e rendit të ditës, e jo tash ne të diskutojmë për këtë me zyrtarin ligjor. Këtë po e them për faktin që mos me u na u kthye vendimet e kuvendit mbrapa nga Ministria, siq ka ndodhur disa herë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Për qështjen e hapave kemi pas vendim të kuvendit, e para shpallja nuk është bërë komplet. Sa i perket afatit të gjashtë mujorshit zgjedhor problem kemi vetëm nëse zgjedhjet shpallën sot.

**z.Shefki Dauti;** Këto dokumente është dashtë të jenë sot në Kuvend .Si do ta votojmë “për” kur nuk i dijm procedurat e vlersimit. Po ashtu kemi pas gjashte ofertues ndërsa komisioni ka zgjedh pesë ofertues. Thuhet ofertën më të favorshme e nuk thuhet ofertat më të favorshme. Ne duhet ta shohim raportin e pergjithshëm. Unë jam “për” që të zhvillohet biznesi, po duhet të jemi plotesisht në përputhje me procedurat ligjore .

**Kryesuesi i mbledhjes, z.Ruzhdi Jashari;** Kemi edhe një propozim konkret që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

**z.Naim Zejna;** Sa i perket kesaj qeshtje zyrtari ligjor e merr pergjegjesine , sepse une nuk jam zyrtar ligjor. Po më vjen mir që z.Sadik Abazi e ka liruar pronen komunale Nr.333/5. Kemi gjet lëshime të shumta te shumta e investimeve, pastaj te numri i puntoreve, te ankuesi z.Dardan Hysaj “Dizajni”. Në si LDK jemi për me e i përkrahë bizneset, e sidomos pas pandemisë.

**z.Perparim Ramusa;** Unë kërkojë që kemi fjalën edhe për herën e dytë sepse konsiderojë se ka nevojë. Ne e kemi shpallë këtë pronë për biznese. Sqarimet ligjore për sa i perket gjashtë mujorit i

dha zyrtari ligjor. Kam një pyetje per komisionin vleruses, kan aplikuar gjashtë bizense, faktikishtë dy janë eliminuar,sa i perket "Dizajnit" unë nuk jamë i kënaqur me punen e komisionit sepse nuk jan favorizuar bizneset komunale, i është dhene prone nje firme nga komuna tjeter. Pyetje është pse nuk jan perkrahe firmat vendore?

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Po sqaroje se faktet jan ndryshe e ju ashtu siq tha Naimi dhe Shefkiu , krejt zona aty është e shpallur për biznese cep më cep, sepse nuk ka në Davidovc zonë tampon. Në duhet ti rrespektojme krejt procedurat. Krejt jan bere dhe krejt jane ketu. Komisionet e kanë bërë punen e tyre. Hapat teknik janë bërë. Procedura e ankimimit eshte bere brenda afatit ligjor. Ofertat janë bere mbi bazen e kritereve, siq kan qene investimet, numri i puntoreve etj.

**z. Shefki Dauti;** Nuk e kontestova shpalljen por proceduren kam një pyetje, se pse ne nje parcel kemi pesë ofertues të përzgjedhur ?

Ne nuk kemi asnjë informatë se sot duhet votuar, sepse kjo parcele eshte me shume interes, për këte arsye unë konsiderojë se sot kjo nuk duhet me u votua. Siq po shihet askush nuk është për pengimin e bizneseve por procedurat duhet të rrespektohen.

Në vazhdim diskutuan: z.Fehmi Hysenaj (3 herë), z.Perparim Ramusa (2 herë), z.Reshat Mujota (2 herë), z.Skender Hyseni (2 herë), z.Shefki Dauti (2 herë), z.Herolind Selmani (3 herë), z.Isak Muslija, znj.Fatime Ferati, z.Besnik Seferi, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Naim Zejna, z.Muhamet Ademaj.

\* **Kuvendi i Komunës, me 9 vota "Për" me 6 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" vendosi të bëj 5 minuta pauzë në ora 12.30h.**

**Kryesuesi i mbledhjes, z.Ruzhdi Jashari;** Mbledhjen e vazhdoi në ora 12.35h.

Në vazhdim diskutuan: z.Shefki Dauti, z.Naim Zejna, z.Besnik Seferi, z.Fehmi Hysenaj,

**Kryesuesi i mbledhjes, z.Ruzhdi Jashari;** Konstatoi Kuorumin prej 18 delegatëve prezentë në mbledhje.

1. **Kuvendi i Komunës, nanimisht Aprovoi vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, në pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej: 6700m<sup>2</sup> (gjashtëdhjetë e shtatë ari) Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime, i epen firmës "AUTOCENTER A-GRUP" SH.P.K. Nr. i biznesit: 811565540, me përfaqësues Albnor Shehu, i cili nga Komisioni Vlerësues ka fituar 429 ose 85.8% poena.**
2. **Kuvendi i Komunës, unanimisht Aprovoi vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, në pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej: 6900m<sup>2</sup> (gjashtëdhjetë e nëntë ari), Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime, i epen firmës "LONI PERGOLA" SH.P.K. Nr. i biznesit: 811023738, me përfaqësues Sadik Trshana, i cili nga Komisioni Vlerësues ka fituar 419 ose 83.8 % poena.**
3. **Kuvendi i Komunës, unanimisht Aprovoi vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, në pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej: 2928,66 m<sup>2</sup> (njëzet e nëntë ari e njëzet e tetë metra), Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime, i epen firmës N.P.T. "GAJREPI" Nr. i biznesit: 810621096, me përfaqësues, Selman Sokoli, i cili nga Komisioni Vlerësues ka fituar 403 ose 80.6% poena.**
4. **Kuvendi i Komunës, unanimisht Aprovoi vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, në pjesën e Ngatrës Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej: 2728,66 m<sup>2</sup> (njëzet e shtatë ari e njëzet e tetë metra), Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime, i epen firmës D.P.Z. "FIDANI -PLAST" Nr. i biznesit: 810622044, me përfaqësues, Xhelal Gashi, i cili nga Komisioni Vlerësues ka fituar 384 ose 76.8% poena.**

5. **Kuvendi i Komunës, unanimitisht aprovoi vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, pronën e paluajtshme Komunale, në pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej: 2728.66 m<sup>2</sup> (njëzet e shtatë ari e njëzet e tetë metra), Zona Kadastrale – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime, i epen firmës D.P.Z. “DIZAJNI” , Nr. i biznesit: 811024075, me përfaqësues, Dardan Hysaj, i cili nga Komisioni Vlerësues ka fituar 361 ose 72.2% poena.**

#### Pika 4

##### Raporti tremujor Buxhetor Janar-Mars 2021

Në këtë pikë përsëri kryesimin e mbledhjes e mori: Kryesuesja znj.Medina Brahaj.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën ja dha Kimete Ukaj.**

**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, në pikat kryesore lexoi raportin. Ajo tha se raportin e keni marrë me kohë, prandaj nëse ka pyetje, jam këtu për tu përgjigjur,

Në vazhdim diskutuan: z.Shefki Dauti, z.Ruzhdi Jashari, z.Fehmi Hysenaj, z.Muhamet Ademaj.

**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Sa i përket raportit shihet një rritje sipas alokimit, por tani jemi në fazën e tenderimit.

**Kryesuesja; znj.Medina Brahaj;** Konstatoi se janë 13 delegatë prezentë në mbledhje:

**\* Kuvendi i Komunës, me 12 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, aprovoi, Raportin tremujor Buxhetor Janar-Mars 2021.**

#### Pika 5

##### Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

Në vazhdim diskutuan: z.Ruzhdi Jashari (2 herë), z.Fehmi Hysenaj, z.Shefki Dauti, z.Naim Zejna, z.Muhamet Ademaj.

Sqarime dhanë znj:Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare, si dhe Kryetari z.Naim Ismajli.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi se janë 18 delegatë prezentë në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimitisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën afatmesme buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2022-2024, për afatin prej 15 ditësh: Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Zyra për Financa, Komiteti për Politikë e Financa, dhe Zyra për Informim.**

**\* Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, aprovoi Vendimin për ndarjen e shumë prej 5000 (pesëmijë) euro, për organizimin e një puntorie jashtë Kosovës, me qëllim të trajtimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2022-2024.**

#### Pika 6

##### Rishqyrtimi i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoha, sipas rekomandimit të MPL-së

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën ja dha Kimete Ukaj.**

**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Lexoi dokumentin për këtë pikë, në vazhdim i ftoi që ta miratojnë, dhe tha nëse ka pyetje do të përgjigjem.

Në vazhdim diskutuan: z.Shefki Dauti, z.Naim Zejna, z.Ruzhdi Jashari, z.Fehmi Hysenaj, dhe z.Muhamet Ademaj.

**Kryetari, z.Naim Ismajli;** Dha sqarime në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi se janë 17 delegatë prezentë në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimitisht aprovoi, ndryshimet në Rregulloren Komunalë për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021, Npi – 01/17 datë: 28.01.2021, si vijon:**

1. Në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2021, Npi – 01/17, Neni 6 deri te neni 6.15 komplet hiqet (fshihet) nga Rregullorja.  
(A r s y e t i m: Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, tarifat për shërbimet kadastrale do të zbatojë drejtëpërdrejtë nga MEA-AKK-Prishtinë, pa qenë e obliguar që të njejtat të përfshihen në Rregulloren Komunale).
2. Propozim i ri: Te neni 4.7 shtohen edhe fjalët, “Lirohen edhe të gjitha subjektet afariste që kanë në shfrytëzim pronat e pa luajtshme komunale në bazë të vendimeve për dhënien në shfrytëzim pronën e pa luajtshme komunale” sipas neneve 4.2 dhe 4.3.
3. Përmirësohet baza ligjore e Rregullosës për ndyshimin e Rregullosës për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2021, Npi-01/17 date 28.01.2021, si vijon: “Bazuar në nenin 12.2. pika (c) dhe nenin 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Veteqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenet 10 deri në 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Neni 15.1.8 neni 23 dhe 34 të Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060; Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës”.

#### Pika 7

Draft-Statuti i ri i QKMF-së “Vezir Bajrami” në Shtime. (Pas diskutimit publik)  
 Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Musa Baftiut.  
 z. Musa Baftiu, drejtor i DSHMS; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit; prezantoi këtë pikë dhe tha se diskutimin publik e kemi organizuar, sipas vëndimit që e ka marrë Kuvendi. Materialin e keni pranuar dhe besoj e keni lexuar, kështu që unë ju ftoj që ta miratoni, dhe nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.  
 Në vazhdim diskutuan: z. Naim Zejna, z. Perpaerim Ramusa, z. Ruzhdi Jashari, z. Muhamet Ademaj, Kryetari, z. Naim Ismajli; Dha sqarime në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.  
 Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi se janë 19 delegatë prezentë në mbledhje.  
 \* Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim”, aprovoi Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Vezir Bajrami” në Shtime.

#### Pika 8

Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht.  
 (Pas diskutimit publik)  
 Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.  
 Në vazhdim diskutuan: z. Ruzhdi Jashari.  
 znj. Shqipe Rexhaj, drejtorëshë e DPUKGJ; Përshëndetje, unë e kam bërë ftesën për diskutim publik dhe e kemi përgatitur një procesverbal, nuk e di a është përcjelluar te ju.  
 Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Po është përcjellur.  
 Në vazhdim diskutuan: z. Naim Zejna, z. Reshat Mujota, z. Perparim Ramusa, z. Fehmi Hysenaj, z. Muhamet Ademaj, z. Shefki Dauti (2 herë), z. Ruzhdi Jashari, z. Besnik Seferi,  
 Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi se janë 19 delegatë prezentë në mbledhje.  
 \* Kuvendi i Komunës, me 18 vota “Për” me 1 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim”, vendosi që pika e 8 (tetë) e rendit të ditës “Propozim-Vendim për ndryshim të destinimit të shkollës dhe oborrit të shkollës në Llanisht”, (Pas diskutimit publik), të shtyhet për shqyrtim, deri në mbledhjen e radhës.



Pika 9

Propozim-Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së "Adem Jasharit", (pas diskutimit publik)

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Lumni Amrushit. **z. Lumni Amrushit, drejtor i DKRS;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoi dokumentin të cilin tha se e keni marrë me kohë në formë të shkruar, prandaj nëse ka vërejtje ose pyetje do te përgjigjem.

Në vazhdim diskutuan: z. Shefki Dauti, z. Fehmi Hysenaj (2 herë), z. Naim Zejna (2 herë), z. Muhamet Ademaj, z. Ruzhdi Jashari, znj. Arbenita Halimi, znj. Fatmire Ferati, z. Perparim Ramusa (2 herë), z. Skender Hyseni, z. Besnik Seferi, z. Reshat Mujota, znj. Adelina Beqaj,

**Kryetari, z. Naim Ismajli;** U përgjigj në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Konstatoi se janë 19 delegatë prezentë në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi, Vendimin që Shtatoren e Komandantit Legjendar të UÇK-së "Adem Jashari" ta vendosë në "Sheshi i UÇK-së" (trekëndëshi) në qytetin e Shtimes.**

**\* Kuvendi i Komunës, me 18 vota "Për" me 1 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim", aprovoi, Vendimin që të Zhvendoset Skulptura "Tri Tytat" nga Sheshi i UÇK-së ku gjendet tani dhe të vendoset në mes të Udhëkryqit të fshatit Belinc (lokacioni ku kryqëzohen rrugët Shtime-Carralevë-Zbore) afër varrezave të Dëshmorëve në qytetin e Shtimes.**

Pika 10

Informatë nga Sektori i Bujqësisë për mbjelljet pranverore

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bashkim Ahmetit. **z. Bashkim Ahmeti, zyrtar i bujqësis;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoi dokumentin të cilin tha se e keni marrë me kohë në formë të shkruar, prandaj nëse ka pyetje do te përgjigjem.

Në vazhdim diskutuan: z. Skender Hyseni, z. Reshat Mujota, z. Ruzhdi Jashari.

**z. Bashkim Ahmeti, zyrtar i bujqësis;** U përgjigj në pyetjet e anëtarëve të Kuvendit

Pika 11

Informatë nga DKA-ja për profilet e shkollës së mesme


**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Agime Roshaj. **znj. Agime Roshaj, drejtoresh e DKA;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoi dokumentin të cilin tha se e keni marrë me kohë në formë të shkruar, prandaj nëse ka pyetje do te përgjigjem.

Në vazhdim diskutuan: z. Fehmi Hysenaj, z. Naim Zejna (2 herë), z. Shefki Dauti, z. Ruzhdi Jashari, z. Muhamet Ademaj,

**znj. Agime Roshaj, drejtoresh e DKA;** Sqaroi disa pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Ju falënderoj për diskutimet, dhe për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendit, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 15.11h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj

